

Tirane, me 07 korrik 2022

**AKT THEMELIMI - STATUT iSHOQERISE  
“IREA.AL” SHPK  
(Shoqeri me Pergjegjesi te Kufizuar)**

Ky Statut hartohet ne perputhje me Ligjin Nr. 9901, date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare" (te ndryshuar) dhe ligjin nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit".

**Kreu I**

**Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia**

**Neni 1:**

**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

1. Sot, me date 07 korrik 2022, une themeluesi Aleksander Frangaj kam vendosur krijimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar me emrin **“IREA.AL” SHPK** (me poshte referuar si "Shoqeria") dhe me emrin tregtar **“IREA.AL”**.
2. Themeluesi i Shoqerise eshte: **Aleksandër FRANGAJ**, shtetas shqiptar, i biri i Vasilit, lindur me 04.10.1968 ne Lezhe, banues ne adresen: Kompleksi “Rolling Hills”, Vila Nr. 87, Mullet, Tirane, i pajisur me karten e identitetit me numer personal: G81004099S, madhor dhe me zotesi te plete juridike per te vepruar.

**Neni 2:**

**Objekti**

Objekt i aktivitetit te shoqerise eshte: tregtar, dhenie-marrje me qira pasuri te luajtshme dhe te paluajtshme, ndermjetesim, import -eksport, organizimi i te gjitha aktivitetave kulturore, artistike, sportive te lejuara me ligj. Shoqeria mund te kryeje operacione tregtare, mbi pasuri te luajtshme dhe te paluajtshme, qe do te vleresoher te nevojshme apo te dobishme per realizimin e objektit te shoqerise si dhe te bleje pjesemarrje ne kapitalin themeltar te shoqerive te tjera qe kane objekt te ngjashem apo te perafert me te vetin.brenda Brenda kufijve te percaktuar nga ligji mund te lesjoje garanci, letra demshperblimi dhe çdo garanci tjeter reale. Shoqeria ne ushtrimin e aktivitetit te saj, do te marre te gjitha autorizimet e lejet e nevojshme prane institucioneve publike shqiptare, dhe do te mbeshtetet ne rregullat dhe normat ne fuqi ne lidhje me ushtrimin e veprimtarise se saj te rregullt ekonomik.

Kryerja e aktivitetetit te marketingut, te agentit komisioner apo te perfaqesuesit per firmat e ndryshme te vendit apo te huaja. Konsulencen ne fushen juridike - ekonomike, mediatike, marketing.

Pjesmarja, ndjekja dhe kontrolli i pjesmarjjes ne pronesine e shoqerive te tjera, ku ajo gezon te drejten e pronesise.

Cdo veprimtari tjeter te lejuar me ligj, qe ka lidhje direkte apo indirekte me objektin e veprimtarise dhe me aktivetite te ngashme apo te lidhura me te.

**Neni 3:**

**Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me afat te pacaktuar.

**Neni 4:**

**Selia**

1. Selia e shoqërisë ndodhet ne adresën: Rruga Aleksander Moisiu, Nr.97, Ish-Kinostudio, Tirane, Shqipëri.
2. Shoqeria ka te drejte te hape dege apo filiale, zyra perfaqesimi, ne te gjithe vendin gjate aktivitetit te saj, brenda ose jashtë territorit te vendit.

**Kreu II Kapitali**

**Neni 5<sup>i</sup>**

**Kapitali themeltar**

1. Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **24,000,000 leke shqiptar** (njezet e kater milion).
2. Pjesëmarja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
3. Ortaku themelues Aleksander Frangaj: Zoterues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 24,000,000 leke shqiptar që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

### Neni 6:

#### Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

1. Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënskrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar per keto kontribute sipas kërkesës së administratorit.
2. Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
3. Zvogelimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kerkohen për ndryshimin e statutit.
4. Në të gjitha rastet zvogelimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

### Neni 7

#### Transferimi i kapitalit

1. Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyremund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
  - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
  - b) shitblerjes;
  - c) trashëgimisë;
  - d) dhurimit;
  - e) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.
2. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.
3. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

## KREU III

### ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

### Neni 8

#### Organi Vendimmarres

1. Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise dhe organi i vetem i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modalitetave te percaktuara ne ligj.
2. Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërin për çështjet e mëposhtme:
  - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) ndryshimet e statutit;
  - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
  - d) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - e) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;
  - f) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
  - g) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
  - h) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - i) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - j) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - k) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - l) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - m) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
3. Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga njëortak tjeter apo nga një person i tretë.
4. Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
5. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëtin rend dite.

### Neni 9

#### Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

1. Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet e gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë

përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

2. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

#### Neni 10

##### Kuorumi

1. Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave.

2. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

3. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

#### Neni 11

##### Marrja e vendimeve

1. Asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave te zoteruesve te kapitalit, të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

2. Asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje te tjera si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar; ç) përcaktimin e shpërblimeve

d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen epasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;

e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

3. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

#### Neni 12

##### Përjashtimi nga e drejta e votës

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- d) ç) dhënen ose jo të përfitimeve të reja.

2. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë nëtë njëtin konflikt interesit, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.


#### Neni 13

##### Administrimi

1. Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si Administratorë të shoqërisë. Afati i emërit, eshte 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

2. Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

3. Administratori i vetem i shoqerise caktohet z. **TAULAND TORTJA**, shtetas shqiptar, lindur me 04.01.1982 ne Peshkopi, banues ne Tirane, i pajisur me karten e identitetit nr.personal I20104004T, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.



## Neni 14

### Kompetencat e Administratorit

1. Administratori ka të drejtë e detyrohen të:

- a) kryen të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
  - b) përfaqëson shoqërinë tregtare;
  - c) kujdeset përmbytjeve saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - ç) përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë sëveprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përparrë asamblesë së përgjithshme përmiratim;
  - d) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përrrethanat, që kërçenojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - dh) kryen regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
  - e) raporton përparrë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë regtare;
  - ë) kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
  - f) Administratori merr miratim me vendim nga Asambleja e Përgjithshme per cdo kontratë apo marreveshje (veprime me faturim apo arketim pagesë) ne emer dhe per llogari te shoqerise me pale te treta me afat me te gjate se 1 (një) vit dhe/ose me vlore me te larte, per kontratë, se 50.000 Euro ne vit. Kontratat, formalisht te ndryshme, por me objekt te njejtë ose ne thelb te ngjashtë midis te njejtave pale, do te konsiderohen sikur te ishin një kontrate e vetme per llogaritjen e vleres se mesiperme.
2. Administratori eshte i detyruar te therrasi Asamblene e Përgjithshme, në rastet kur:
- a) sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
  - b) shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerëmë të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
  - c) shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
3. Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një Administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.
4. Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojet Administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërbimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

## Neni 15

### Pergjegjesite e Administratorit

1. Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkeljetë ligjeve, për shkelje të statutit, apo përfajtje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

2. Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

3. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mëdës;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm përritjet e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanjojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

4. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

5. Nëse Administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij nenit, eshte i detyruar t'i dëmshpërblojë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të

parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkura. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

6. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
- b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
- c) u shpérndan aktivet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;

d) jep kredi.

7. Përveç padisë për shlyerjen e dëmit që i ngarkohet personalisht administratorit, ortakët individualisht ose se bashku, kanë të drejtë të ngrënë padi penale kundër administratorit.

8. Paditësit kanë të drejtë të ndjekin në rrugë ligjore shlyerjen e plotë të dëmit që i është shkaktuar shoqërisë, përfshirë edhe dëmshpërbimin financiar, nëse është e nevojshme. Asnjë vendim i asamblesë nuk mund të ndalojë ngritjen e kërkesë padisë kundër administratorit për gabimet e kryera prej tij gjatë ushtrimit të detyrës.

#### Kreu IV Viti finanziar-ekspertet

##### Neni 16

###### Viti Financiar

Viti finanziar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finanziar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

##### Neni 17

###### Ekspertet

1. Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithe dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithesvetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer një gje të tille i ngarkuar ngaana e ortakeve.

2. Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit finanziar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'ishqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

#### Kreu V Prishja –riorganizimi i shoqërisë

##### Neni 18

###### Prishja dhe likuidimi

1. Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
  - b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
  - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtar tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

2. Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".

3. Prishja e shoqërise tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

4. Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

### Neni 19

#### Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja

1. Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vednimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

### Neni 20

#### Baza Ligjore

1. Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
2. Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dheshoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.


### Neni 21

#### Mosmarrëveshjet

Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptar.

**ORTAKU I VETEM**  
**I SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

"IREA.AL" SHPK

Aleksandër FRANGAJ  
  
Emer mbiemër(nenshkrimi)

---

<sup>i</sup> Akti i themelimit dhe Statuti janë i njëjtë dokument.